

Pozita e Sunnetit

dhe ndikimi i dijetarëve të Sunnetit
tek njerëzit



nga dijetari i nderuar

Muhamed bin Hadij el Medkhalij



Selefi.org

Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti



Takim i Shejkh Muhamed bin Hadit me
vëllezërit nga Bahrejni

Të gjitha lavdet janë për Allahun, lëvdata dhe shpëtimi qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij, mbi të gjithë shokët e tij si dhe mbi të gjithë ata që i ndoqën me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Më tej:


E falenderojmë Allahun – të Pastrin nga çdo e metë dhe të Lartësuarin – që të na lehtësojë ne dhe të gjithë juve. O ju vëllezër të nderuar nga Mbretëria e Bahrejnit, po ashtu vëllezërit e nderuar nga vendet e tjera Arabe dhe Islame, si dhe në përgjithësi vëllezërit e mi dhe bijtë e mi nga nxënësit e Universitetit Islamik, Allahu ju dhëntë jetë të gjithëve, në këtë natë, nata e së shtunës, më 20 nga muaji i Allahut, Muharrem, sipas takvimit të Ummul-Kura, në këtë xhami në të cilën u morëm vesh që të takohemi. Në xhaminë e vëllait tonë, shejkh Bedri ibn Sefer el-'Utejbi – Allahu i Lartësuar e mëshiroftë – ai është që bëri e këtë xhami dhe dha mund për të, Allahu ia shpërbleftë me të mira.

Dhe e lusim Allahun – e Madhëruar dhe të Lartësuar – që t'i ndërtojë përmes kësaj (vepre) një shtëpi në Xhennet, ashtu siç e lusim Allahun – të Pastrin nga çdo e metë dhe të Lartësuarin – që t'i shpërblejë bamirësit të cilët e morën përsipër rinovimin dhe rregullimin e kësaj xhamie në këtë pamje, t'i shpërblejë të gjithë ata me shpërblimet më të mira. Pra, kushdo që bën vepra të mira, qoftë mashkull apo femër duke qenë besimtar, do ta gjej shpërblimin dhe veprën e mirë tek Allahu në Ditën e Kijametit. Ai do ta gjej shpërblimin dhe veprën e mirë të tij edhe në jetën e kësaj bote.

Ju dëshirojmë mirëseardhje të gjithëve në këtë takim, për të cilin i lutemi Allahut – të Pastrit nga çdo e metë dhe të Lartësuarit –, ashtu siç na lehtësoi këtë takim, ta bëjë atë të begatë

O vëllezër! Me të vërtetë, jeta e lumtur dhe e vërtetë është ajo jetë që ndërtohet mbi devotshmëri (takua) për Allahun – të Madhëruarin dhe të Lartësuarin –. Ai që e ka frikë Allahun – të Pastrin nga çdo e metë dhe të Lartësuarin – gëzohet në dynja si dhe gëzohet në botën tjetër, ngase lumturia është synimi i dëshiruar në këtë botë si dhe në botën tjetër, kurse në botën tjetër është akoma më e madhe (lumturia), sepse ajo është Shtëpia e Përrjetshme.

﴿وَأَمَّا الَّذِينَ سَعَدُوا فَفِي الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ إِلَّا مَا شَاءَ رَبُّكَ عَطَاءٌ



“Kurse të lumturit, do të hyjnë në Xhenet, ku do të qëndrojnë përherë, derisa të jenë qiejt dhe Toka, përveç si të dojë Zoti yt: një dhuratë të pandërprerë.”¹

Do të thotë: i vazhdueshëm.

Pra ata janë në një lumturi të përhershme. Kjo lumturi është lumturia e vërtetë dhe kjo lumturi nuk arrihet veçse me devotshmëri (takua), dhe nuk ndërtohet përveç se me devotshmëri, dhe njeriu nuk mund ta arrijë devotshmërinë përveç se me diturinë e saktë, e cila dituri e udhëzon atë që ta ketë për qëllim Allahun dhe të Dërguarin e Tij, kështu, e arrin atë, dhe e udhëzon atë që të urrej për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe kështu u shmanget atyre.

Pra, devotshmëria është që të punosh duke u bazuar në dritën (diturinë) e Allahut, duke iu bindur Allahut, të shpresosh në shpërblimin e Allahut dhe të kesh frikë nga dënimi i Tij – të Pastrit nga çdo e metë dhe të Lartësuarit –. Nëse çështja qëndron kështu, atëherë kjo dituri është një çështje kryesore dhe themelore për njohjen e mirësisë dhe udhëzimit, dhe njohjen e sherrit dhe shkatërrimit, ngase vërtetë e kundërta (e një gjëje) e shfaq bukurinë e saj e kundërta e saj, dhe më të kundërtën e saj, dallohen gjërat.

Nëse e njohë të mirën i afrohesh asaj, dhe nëse e njeh të keqen i largohesh asaj. Dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm se me dije, të cilën Allahu – i Pastri nga çdo e metë dhe i Lartësuar – e bën dritë në zemrën e besimtarit, dhe përmes saj ai bën dallim në mes të vërtetës dhe të pavërtetës.

Nëse doni, lexojeni argumentin për këtë në Fjalën e Tij – të Madhëruarit dhe të Lartësuarit –:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن تَتَّقُوا اللَّهَ يَجْعَلْ لَكُمْ فُرْقَانًا وَيُكَفِّرْ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ

“O ju që keni besuar! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë juve *Furkan* (një kriter për të gjykuar në mes të drejtës dhe të gabuarës), do t’ua fal gjynahet tuaja.”²

¹ Hud, 108.

Pra, *Furkani* me të cilën bëhet dallim në mes të vërtetës dhe të pavërtetës nuk mund të arrihet veçse me dituri.

فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مُتَقَلَّبَكُمْ وَمَثْوَاكُمْ

“Dije se nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe kërko falje për gjynahun tënd dhe (po ashtu kërko falje) për besimtarët dhe besimtaret. Allahu e di se ku silleni ju dhe ku qëndroni.”³

Ajetet që kanë të bëjnë me devotshmërinë janë të shumta, që tregojnë për gjurmët e saja në këtë botë dhe në ahiret. Dhe ky nuk është rasti për t’i përsëritur ato, porse neve deshëm të sqarojmë se kjo devotshmëri dhe përkufizimi i saj nuk mund të jetë vetëm se me dije. Kurse dija e vërtetë është ajo që na ka trashëguar i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – me fjalën e tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*:

إِنَّ الْعُلَمَاءَ هُمْ وَرَثَةُ الْأَنْبِيَاءِ إِنَّ الْأَنْبِيَاءَ لَمْ يُوَرِّثُوا دِينَارًا وَلَا دِرْهَمًا إِنَّمَا وَرَّثُوا الْعِلْمَ فَمَنْ أَخَذَهُ أَخَذَ
بِحِظٍّ وَافِرٍ

“Vërtetë, dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë në trashëgimi as dinar e as dirhem, por ata kanë lënë në trashëgimi dituri, ai që e merr atë ka marrë një hise të madhe.”

Kurse, dijen që na e ka lënë mbrapa neve i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – është shpallja, Libri dhe Sunneti. Libri i Allahut – *të Madhëruar e të Lartësuar* – me të cilin na ka porositur ai – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – në fund të jetës së tij, ashtu siç ka ardhur në hadithin e vërtetë, hadithi i Gadir Khum, me fjalën e tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*:

“Ju kam lënë dy gjëra, përderisa kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni pas meje kurrë: Libri i Allahut.”

² El-Enfal, 29.

³ Muhamed, 19.

Pastaj, përmendi Librin e Allahut – të Pastrin nga çdo e metë dhe të Lartësuarin – dhe nxiti drejt tij, ta marrim dhe të kapemi fort pas tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*. Pra, kjo është dituria me të cilën erdhi ai – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – dhe ai është që ka thënë për të (Kuranin):

“Nuk ka patur ndonjë prej Pejgamberëve që kanë qenë para meje, vetëm se i është dhënë diçka si ai që i kanë besuar njerëzit.”

D.m.th nga muxhizet (mrekullitë).

Dhe ai – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – tregoi për mrekullinë e cila i është dhënë, ai tha:

“Ndërsa ajo që m’u dha mua është ky Kuran, kjo shpallje. Andaj, shpresoj që të jem prej atyre (Pejgamberëve) që do të kenë më shumë pasues në Ditën e Gjykimit.”

Dhe qëllimi me këtë është se Pejgamberët e mëparshëm – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta* – mrekullitë e tyre kanë përfunduar me mbarimin e kohës së tyre, gjatë jetës së tyre. Pra, shkopi i Musait, bardhësia e dorës së tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – e deri në fund të nëntë shenjave të tij, që i janë dhënë gjatë jetës së tij, dhe këto kanë përfunduar me mbarimin e kohës së tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –, pra kur ai vdiq, u ndërprejnë këto mrekulli.

Po kështu edhe Isa – *lëvdata më e mirë dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi Pejgamberin tonë* –, e shëronte të verbrin, të lebrosurin me lejen e Allahut, dhe i ngjallte të vdekurit me lejen e Allahut, e deri në fund të çudive dhe mrekullive me të cilat erdhi përmes të cilave Allahu e ndihmoi, siç e dini.

Si dhe fryrja e tij tek zogu të cilin e krijonte prej dheu, dhe pastaj frynte tek ai dhe ai bëhej shpend (i gjallë) me lejen e Allahut. Të gjitha këto mbaruan bashkë me të – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –. Porse, Pejgamberi jonë – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – mrekullia me të cilën e sfidoi popullin e tij, të zotët e oratorisë dhe retorikës, zotërinjtë e stilistikës, erdhi me të (Kuranin) dhe të zotët e kësaj çështje – të zotët e oratorisë dhe retorikës dhe zotërinjtë e stilistikës – ishin të paaftë të vinin me diçka të tillë sikur ai, apo me dhjetë Sure sikur të atij, dhe me një Sure sikur ai, Allahu i sfidoi me të.

Pra, besuan ata që Allahu ua kishte shkruar se do besonin që në fillim, nga ata që e panë oratorinë e këtij Libri. Dhe më vonë besuan ata që deshi Allahu – i Madhëruar e i Lartësuar – që të besojnë më vonë. Dhe pas kësaj, Pejgamberi – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – ngeli për një kohë të caktuar derisa Allahu – i Madhëruar e i Lartësuar – i zbriti atij:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا فَمَنِ اضْطُرَّ فِي مَخْمَصَةٍ
غَيْرِ مُتَجَانِفٍ لِإِثْمٍ فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٢٥٨﴾

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”⁴

Pastaj, (i Dërguari i Allahut – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të –) iu bashkëngjit Shoqërisë së Lartë, afër Zotit të tij – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – dhe mrekullia e tij (Kurani) ngeli mbrapa tij.

Pra, askush nuk mund të shprehet si ky Kuran.

قُلْ لِّإِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَى أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ
بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا ﴿٢٥٩﴾

“Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.”⁵

D.m.th, ta përkrahnin dhe të mbështesnin njëri-tjetrin. Allahu i sfidoi më këtë Kuran deri në Ditën e Kijametit.

Dhe për këtë arsye ka vazhduar kjo mrekulli, dhe nuk sheh në ndonjë kohë prej kohërave dhe lexon, përveç se dëgjon se dikush beson kur e lexon këtë Libër apo e dëgjon të lexohet ky Libër. Pra, kjo është Dija (Kurani) me të cilën erdhi Pejgamberi –

⁴ El-Maideh, 3.

⁵ El-Isra, 88.

lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – kurse shpallja e dytë është Sunneti Profetik, i cili e shpjegon Kuranin dhe e shtjellon si dhe e sqaron atë, e kushtëzon atë që është absolute dhe e shtjellon atë që është e përgjithshme, dhe e specifikon atë që është e përgjithshme, e deri në fund të asaj që ju e dini, në lidhje me shkencën e Hadithit, dhe shkencën e Usul-Fikhut.

Ky Sunnet është shpallja e dytë. Ne themi shpallja e dytë duke marrë në konsideratë atë se ai nuk lexohet (ashtu siç lexohet Kurani në namaz, sh.p), përndryshe ai është sikur Kurani në qoftë se saktësohet zinxhiri i tij deri tek i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –. Është shpallje nga Allahu siç është Kurani, ai – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – ka thënë në hadithin ‘Ijad ibn Himar el-Muxhash’i:

“Më është dhënë Kurani dhe diçka i ngjashëm me të.”

Pra, Sunneti është sikur Kurani në ligjëvënie, por dijetarët thonë se ai është shpallje e dytë duke e marrë në konsideratë aspektin se ai është shpallje që nuk lexohet (ashtu siç lexohet Kurani në namaz, sh.p).

Ka thënë – i Madhëruari dhe i Lartësuari – :

مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَى ۚ وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ۚ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ۖ عَلَّمَهُ
شَدِيدُ الْقُوَىٰ ۖ

“Shoku juaj (Muhamedi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk ka humbur e nuk ka devijuar! Ai nuk flet sipas epsheve të tij. Porse ajo është shpallje që i shpallet. Atë ia ka mësuar atij (ia ka zbritur) një (engjull) shumë i fuqishëm .”⁶

D.m.th. Xhibrili.

Sem’atije – Allahu e mëshiroftë – i cili është nga Tabi’inët, ka thënë: “Xhibrili ia zbriste Sunnetin Pejgamberit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – ashtu siç ia zbriste Kuranin.” Pra, ai është njësoj sikur Kurani, nëse saktësohet zinxhiri i tij deri tek Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – është sikurse ai (Kurani). Pa dyshim, se është shpallje nga Allahu siç është Kurani, mund ta shikoni te Sureja en-Nexhm, mësojeni atë përmendsh dhe mos u shkurajoni.

⁶ En-Nexhm, 2 -3.

Pra, dituria me të cilën njeriu arrin devotshmërinë dhe bën dallim në mes të vërtetës dhe të pavërtetës, hajrit dhe sherrit, udhëzimit dhe devijimit, Sunetit dhe bidatit, është ajo me të cilën erdhi i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij* –. Ai që e pason atë, me të vërtetë ka ngadhënjyer dhe ka korrur sukses, dhe ai që kundërshton, me të vërtetë ka dështuar dhe është shkatërruar. I lutemi Allahut për mirëqenie dhe shpëtim.

Kjo dituri me të cilën arrihet devotshmëria është zgjidhje gjatë shfaqjes së fitneve. Kështu që, dalja nga fitnet është përmes të kapurit fort pas Kuranit dhe Sunnetit, jo me fjalën e një filani e as të një filani tjetër, ngase nuk ka njeri që nuk është i ekspozuar ndaj gabimeve dhe që nuk ka mundësi të bjerë në gabime, ndërsa Libri i Allahut dhe Sunneti i të Dërguarit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – janë referencë gjatë fitneve.

“Me të vërtetë, ai që do të jetojë pas meje do të shoh kundërshtime të mëdha. Andaj, ju e keni për detyrë të kapeni pas Sunnetit tim dhe Sunnetit të Udhëheqësve të Drejtë e të Udhëzuar.”

Dikush mund të thotë: Përse nuk e ka përmendur këtu Kuranin?! Përgjigja është se Kurani përmban këndvështrime të ndryshme, ngase çdonjëri e komenton Librin e Allahut ashtu siç ia ka ëndja atij, dhe përpiket që ta ‘tërheq’ në anën e tij, mirëpo nëse vjen Sunneti nga i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – që është shpjegues dhe sqarues i Librit, morri fund këndvështrimi i çdonjërit me shpjegimin apo mendimin e tij.

Dhe nëse Sunneti transmetohet nga Udhëheqësit e Drejtë për diçka që nuk ka ardhur nga i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – morri fund mendimi i çdonjërit përball tij (Sunetit). Atëherë, nuk ka ndonjë të pretendojë se ai është më i ditur se Libri i Allahut dhe qëllimi i të Dërguarit të Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – që nga Ebu Bekri, ‘Umeri, ‘Uthmani dhe ‘Aliju si dhe ata që ngelën nga Dhjetë (të përgëzuarit me Xhenet) dhe Sahabët e tjerë – *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë* –, të cilët jetuan bashkë me Pejgamberin – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – e panë atë, dhe e përjetuan periudhën e shpalljes, dhe e kuptuan synimin e Allahut, dhe e mësuan tefsirin (e Kuranit) nga i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –, shpallja zbriti në mesin e tyre, dhe ata punuan me atë që punoi i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – nga Libri i

Allahut, dhe atë që e sqaroi Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – e morën atë.

Askush nuk beson se është më i ditur se ata, sepse njëri prej tyre i cili e shoqëroi Pejgamberin – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – është më i mirë për shkak të shoqërimit të tij (me Pejgamberin) nga të gjithë ata që kanë ardhur pas tij prej Tabi'inëve, edhe në qoftë se Tabi'ini e takon Allahun me çdo punë të mirë. Siç e ka thënë këtë Imam Ahmedi – *Allahu e mëshiroftë* -. Gjithashtu e ka thënë këtë 'Alij ibën Medini – *Allahu e mëshiroftë* -, dhe siç e kanë thënë këtë Imamët e Sunnetit dhe hadithit.

E si të mos jetë ashtu, kur ata e kanë patur nderin e shoqërimit (me të Dërguarin e Allahut), e cila nuk barazohet me asgjë. Pra, ata janë përcjellësit e Fesë tek ne dhe mbartësit e Sheriatit derisa na e sollën neve atë – *Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me të gjithë* -. Pra, ata janë të cilët na ka udhëzuar Allahu përmes tyre me mirësinë e Tij. Zinxhiri lidhës nga i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta* – është përmes tyre dhe ai që i shan ata apo i cilëson me mangësi, nuk ka mirësi tek ai dhe nuk lejohet të ulesh me të sepse ai është njeri i keq.

Dhe ai që ua përmend disave prej tyre disa mangësi të tyre apo ndonjë gabim që e kanë bërë ata, nuk ka mirësi tek ai njeri dhe ai është bidatçi – siç e ka thënë këtë Imami i Ehli Sunnetit dhe Hadithit, Ebu 'Abdil Ahmed ibën Hanbel – dhe është pajtuar me të miku i tij, vëllai i tij dhe shejkhu i tij në të njëjtën kohë, 'Alij ibën Medini dhe janë pajtuar për këtë Imamët e tjerë të Sunnetit.

Ai që e sulmon njërin nga Sahabët e Pejgamberit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – dhe e përmend atë për të keq, apo e përmend për ndonjë gabim që i ka ndodhur atij, atëherë ai është njeri i keq, bidatçi, nuk lejohet ulja me të, derisa zemra e tij të jetë e qetë ndaj të gjithë shokëve të të Dërguarit të Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – dhe të tregoj mëshirë për të gjithë ata, dhe zemra e tij të jetë e qetë ndaj tyre. Pra, Sahabët janë përcjellësit e Librit dhe përcjellësit e Sunnetit deri te neve – *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë* -.

Pra, dituria e përcjellë nga i Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – e deri tek ne, ata janë ndërmjetësuesit e kësaj diturie. Nëse do të pasosh, atëherë e ke për detyrë që të kapesh fort pas tyre, kapu pas tyre. Ajo në të cilën ishin ata, ajo

është fe dhe atë që nuk e njihnin ata, ajo nuk ka të bëjë asgjë me fenë, nuk ka të bëjë asgjë me fenë. Kjo është dituria.

الْعِلْمُ قَالَ اللَّهُ قَالَ رَسُولُهُ

Dija është “ka thënë Allahu”, “ka thënë i Dërguari”,

قَالَ الصَّحَابَةُ هُمْ أَوْلُو الْعِرْفَانِ

Dhe “kanë thënë Sahabët”, ata janë njerëzit me dituri.

مَا الْعِلْمُ نَصَبُ كُلِّ خِلَافٍ سَفَاهَةً

Nuk është dija t’i hysh përciptazi kundërshtimit.

بَيْنَ الرَّسُولِ وَبَيْنَ رَأْيِ فُلَانٍ

mes të Dërguarit dhe mendimit të filanit.

وَالْعِلْمُ أَقْسَامٌ ثَلَاثٌ مَالَهَا مِنْ رَابِعٍ وَالْحَقُّ ذُو تَبَيَّانٍ

Dija është tre kategori dhe të katër nuk ka, kurse e vërteta ka qartësi

E deri në fund të poemës.

Pra, thelbi i gjithë kësaj është se njeriu ngritet aq sa kapet pas Sunnetit të të Dërguarit të Allahut – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të –, dhe zbret dhe ulet me aq sa ndahet prej tij (Sunnetit). Pra, kjo është peshorja me të cilën ‘peshohen’ burrat, dhe ai i cili është përkrahës i Sunnetit të të Dërguarit të Allahut – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – dhe është krenar me të, është kryelartë me të, ai ngritet. Ai i cili nuk është i tillë, atëherë ky ulet, edhe sikur të jetë nga më të mëdhenjtë e banorëve të tokës.

Pra, peshorja tek ne është me pasim, e jo me shpikje. Në këtë aspekt, njeriu njihet me aq sa kapet pas asaj që ishte i Dërguari i Allahut – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – dhe shokët e tij – Allahu qoftë i kënaqur me ta –.

“Ai që do të jetojë prej jush, do të shoh kundërshtime të mëdha. Andaj, ju e keni për obligim që të kapeni pas Sunnetit tim dhe Sunnetin e Udhëheqësve të Drejtë e të Udhëzuar që do vijnë pas meje, kapuni fort pas tij.”

Pra, kapja fort pas Sunnetit është mbrojtja dhe është suksesi dhe kapja pas pasuesve të Sunnetit, te cilët njihen me të, kjo është rruga e mirësisë dhe shpëtimit. Po ju rrëfej dy ngjarje dhe me të tretën po e mbyll.

Ngjarja e parë ka të bëjë me Sufjan ibën Se'id eth-Theurij – *Allahu i Lartësuar e mëshiroftë* -. Në fillim ai kishte diçka prej *teshejj'u*.⁷ Ai doli – *Allahu i Lartësuar e mëshiroftë* – në kërkim të hadithit, ai bashkë me xhematin, kishte me vete bashkëkohësit e tij, të rinjtë nga banorët e Kufës. Kështu që, u ndanë, çdonjëri prej tyre mori një drejtim të caktuar. Kurse ai (Sufjan eth-Theurij) u nis për në Basra. Ai kishte diçka prej kësaj (*teshejj'u*), në dhënien përparësi, kështu që, e begatoi Allahu dhe u takua me Ejub es-Sikhtijanin dhe me Abdullah ibën 'Aun Narkaban, Allahu i bëri dobi përmes këtyre dyve dhe ai e braktisi *teshejj'u*-in.

Përse? Sepse ai i gjeti ata në Sunnet dhe ata i transmetonin hadithe të Pejgamberit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të* – në lidhje me këtë çështje (*teshejj'u*), e cila çështje nuk i kishte arritur atij. Ky medh'heb ishte përhapur në shoqërinë e Kufes, në fillim fare, e ajo ishte çështja e dhënies përparësi Alijut ndaj Uthmanit.

Pas kësaj, Sufjani eth-Theurij u pendua dhe kur ai pyetej më herët për medh'hebin e tij për këtë çështje, thoshte: “Unë jam një njeri nga banorët e Kufes, dhe njeriu është në medh'hebin e vendit të tij.” Pra, ai kishte mendimin se ka përparësi Aliju ndaj Uthmanit – *Allahu qoftë i kënaqur me ta* -. Kështu që, këtu përfitoi nga Ejub es-Sikhtijani dhe Ibën 'Auni. Po ashtu (i bëri dobi) edhe Jusuf ibën Asbat. Shikoni se si ndikoi!

⁷ *Teshejj'u* në traditën e të mëhershmeve është besimi i dhënies përparësi Alijut – *Allahu qoftë i kënaqur me të* – ndaj Uthmanit – *Allahu qoftë i kënaqur me të* –, dhe se Aliju kishte të drejtë në luftrat e tij, kurse ai që e kundërshtonte, e kishte gabim. Ndoshta disa prej tyre besonin se Aliju është krijesa më e mirë pas të Dërguarit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta* –, nëse ky besim është si devotyshmëri, fe, besnikëri dhe ixhtihad, atëherë nuk refuzohet transmetimi i tij (në hadith) për këtë gjë, sidomos nëse ai nuk therrët për tek kjo gjë. Kurse *teshejj'u*-i në traditën e të mëvonshme është rafidizmi (i Rrafidijve), nuk pranohet transmetimi i Rafidiut ekstremist dhe nuk ka nderë për të. Marrë nga “*Tedh'hibu-Tedh'hib*” të Hafidh ibën Haxher el-Askalnit, 1/93.

Jusuf ibën Asbak thotë: Familja ime ishin Rafidij dhe mendimet e tij ishin ato të pasuesve të Kaderit. Pra, i ka ardhur sherri nga të dyja anët. Familja e tij ishin Rafidij dhe mendimet e tij ishin ato të Kaderijve, dhe ai tha se Allahu më bëri dobi përmes Sufjan eth-Theurit. Shiko, se tek kush u kthye shpërblimi! Tek i pari, e ata janë Ejubi dhe Ibën ‘Auni. Përmes këtyre dyve, Allahu e begatoi Sufjan eth-Theurin dhe Allahu e shpëtoi nga teshejj’u në këtë çështje. Pas kësaj, Allahu e begatoi Jusuf ibën Asbat – *Allahu i Lartësuar e mëshiroftë* – përmes Sufjanit, i cili u edukua në një shtëpi Rafidijsh dhe mendimet e tija ishin të pasuesve të Kaderit, kështu që Allahu e begatoi përmes Sufjan ibën Se’id eth-Theurij, dhe më pas Allahu e shpëtoi atë.

Shikoni se si është ndikimi i dijetarëve të Sunnetit tek nxënësit e tyre. Pra, nëse dijetari është sunnij, selefij, etherij, atëherë ai, vërtet i thërret njerëzit tek etheret dhe i bën që të kapen pas etherit, dhe ndikimi tek ata do të jetë ndikimi më i mirë. Dhe nëse dijetari nuk është në këtë (në Sunnet), atëherë zemrat janë tenxhere që gëlojnë me atë që kanë përbrenda, kurse gjuhët janë garuzhdet, e nxjerrin jashtë atë që është në këto tenxhere. Nëse zemrat kanë bidate, atëherë nuk nxjerrin vetëm se bidate – Allahu na ruajttë nga kjo -. Ju përmes kësaj (ngjarje), shikoni se si ka ndikuar Shejkhu (dijetari) tek nxënësi i tij, dhe si ka ndikuar sunniju tek ai që është bashkuar me sunnijun dhe ka ndonjë gjë prej bidateve.

A e shikoni se, sikur të heshtte Ibën ‘Auni dhe sikur të heshte Ejubi, të mos flisnin për këtë gjë (teshejj’u-in), a do të ishte udhëzuar Sufjani? Jo, pasha Allahun. Pastaj, a e patë se sikur të heshtte Sufjani eth-Theurij ndaj sqarimit të hakut dhe këshillimit të njerëzve dhe të heshtte ndaj atyre që e kërkojnë udhëzimin, a do të ishte udhëzuar Jusuf ibën Asbat? Jo, pasha Allahun.

Kurse ai që tha: O ti që po flet për njerëz, ndoshta ndonjërit prej tyre i është caktuar të hyjë në xhenet. Ndërsa ai i tha: Hesht! Unë jam më i mëshirshëm ndaj tyre se sa baballarët e tyre. Unë jam më i mëshirshëm për ta – d.m.th. për pasuesit e bidateve – se sa baballarët e tyre. Unë u sqaroj njerëzve atë që kanë ata (bidate, devijime, gabime, sh.p), kështu ata nuk i pasojnë dhe në këtë mënyrë i zvogëlohen pasuesit atij, përse?! Sepse ai që ka gabime, ai që ka bidate, ai që ka *batil* (të pavërtetë, kotësi) në përgjithësi, nëse njerëzit e pasojnë atë, do të merren mëkatet e tyre dhe do t’i jepen atij (bidatçiu).

Allahu – *i Madhëruar e i Lartësuar* – ka thënë:

لِيَحْمِلُوا أَوْزَارَهُمْ كَامِلَةً يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَمِنْ أَوْزَارِ الَّذِينَ يُضِلُّونَهُمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ إِلَّا سَاءَ مَا يَزُرُونَ

“Ata do t’i mbartin mëkatet e tyre të plota (në shpinat e tyre) Ditën e Gjykimit, si dhe prej mëkateve të atyre që i devijuan pa dije. Sa e keqe është ajo që do ta mbartin ata.”⁸

Ky është argument nga Libri e Allahut. Kurse argument nga Sunneti i të Dërguarit të Allahut – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – është fjala e tij:

“Ai që thërret për në udhëzim, ka shpërblim sikurse shpërblimi i atij që e ka pasuar atë, nuk do t’i pakësohet asgjë nga shpërblimi i tyre. Dhe ai që thërret për në devijim, ka mëkat sikur mëkatet e atyre që e pasojnë atë.”

Kanë ardhur të dyja transmetimet në hadith.

“Nuk do t’i pakësohet asgjë nga mëkatet e tyre.”

Kjo tregon për madhësinë e shpërblimit të atyre që u mësojnë të tjerëve të vërtetën dhe udhëzimin.

Ibën ‘Abdil Berr – Allahu e mëshiroftë – duke e komentuar këtë hadith, thotë: “Ky është hadithi më i madh për mësuesit.”

Pra, ata që u mësojnë të tjerëve mirësinë, Sunnetin dhe udhëzimin, sa shpërblim kanë?! Tani, sa shpërblim ka Sufjan eth-Theurij që u udhëzua Jusuf ibën Asbat nëpërmjet tij? Sepse Jusuf ibën Asbat ishte prej dijetarëve të mëdhenj të Selefëve që u njohën për sqarimin e të kotës (batil) dhe për refuzimin e mashtruesve si dhe për paralajmërimin ndaj bidatçijve, siç dëgjuat tani, pak më parë.

Dhe kjo ndodhi për shkak të ndikimit të shejkhut të tij, Sufjan eth-Theurijt. Kurse Theurij nga kush u ndikua? Nga Ibën ‘Aun dhe Ejub (es-Sikhtijani). Pra, thelbi i gjithë kësaj është se dijetarët e Sunnetit kanë ndikim tek nxënësit e tyre, Allahu i mbron ata me mirësinë dhe mëshirën e Tij nga rënia në bidate dhe shpikjet në fe.

Po kështu edhe Ebu Daudi. Ka jetuar afër (Imam) Ahmedit dhe kur u nis për në Basra, filloi të udhëtonte herë pas herë prej Basras për në Bagdad dhe anasjelltas, duke e

⁸ En-Nahl, 25

vizituar Ahmedin – *Allahu i Lartësuar e mëshiroftë* –, dhe e pyeste atë, saqë shkroi edhe libra për të (Imam Ahmedin) për çështje të ndryshme, për transmetuesit e haditheve, në fikh dhe në Sunnet - *Allahu e mëshiroftë* -. Kështu që, Allahu i bëri dobi përmes shoqërimit të Ahmedit dhe e mbrojti atë nga rënia në fitnen e mendimit të krijimit të Kuranit.

Allahu i mbron nxënësit e dijes me mirësinë dhe mëshirën e Tij, nëse ata u drejtohen dijetarëve të Sunnetit. Dhe për këtë ka ardhur një shprehje e njohur e Selefëve: “Prej begative të Allahut ndaj të riut dhe të huajit (jo-arabit) nëse konvertohen është që të udhëzohen prej një njeriu të Sunnetit dhe të jenë në kujdesin e një dijetari të Sunnetit.” Sepse i riu, nëse vjen tek dijetari dhe shikon tek ai nxitjen e tij (për të kapurit) pas Sunnetit dhe paralajmërimin e tij kundër bidateve dhe shpikjeve në fe, ai që në fillim, do të jetë i qëndrueshëm në fe.

Po kështu, edhe i huaji (jo-arabi). Nëse hyn në Islam, nuk e di gjendjen e muslimanëve, të cilëve u ka ndodhur përçarje, mospajtime, sherr dhe fitne (trazira), e që janë përhapur dhe janë shtuar, kështu që ky (i huaji) nuk di gjë. Ai është me atë të parin që merr dije në fillim, nëse merr dije nga suniju, atëherë ai bëhet sunij (selefij), e nëse merr dije nga bidatçiu, ai është me bidate.

Prej begatisë së Allahut ndaj të huajit nëse konvertohet në Islam është që të udhëzohet tek një njeri i Sunetit. Ajo që kam për qëllim me të gjithë këtë është porosia ndaj bijve të mi, që të kapen pas dijetarëve të Sunetit dhe etherit, të cilët i këshillojnë dhe u sqarojnë atyre dhe i paralajmërojnë ata. Dijetari sunnit në realitet është ai i cili nuk zemërohet për ndonjë gjë prej bidateve nëse përmenden në praninë e tij. Siç e ka thënë këtë Ebu Bekër ibën Ajash – *Allahu i lartësuar e mëshiroftë* – kur u pyet se kush është sunniju? Ai tha: “Ai i cili nuk zemërohet nëse ndonjë gjë prej bidateve përmendet në praninë e tij.”

Pra, nëse përmendet dhe paralajmërohet kundër tyre dhe sqarohet gjendja e tyre (bidateve) dhe gjendja e pasuesve të bidateve, nuk zemërohet. Ky është sunniju. Porse ai që do të jetojë shkel e shko, do t’i kënaq që të gjithë, për ta e ka thënë të vërtetën Shejkhu jonë, kolosi Humud bin Abdullah et-Tu’uejxhri – *Allahu i lartësuar e mëshiroftë* – i cili i ka quajtur ata: njerëz që mbajnë mendjen gjallë. Do të jetojë dhe t’i kënaq të gjithë njerëzit. Kënaqja e njerëzve është një synim që nuk arrihet.

Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta* – thotë në një hadith të vërtetë:

“Ai që i kënaq njerëzit duke e hidhëruar Allahun, Allahu hidhërohet me të si dhe njerëzit hidhërohen me të. Ai që e kënaq Allahun duke i hidhëruar njerëzit, Allahu është i kënaqur me të dhe njerëzit janë të kënaqur me të.”

Pra, ai që e kërkon atë që është tek Allahu është ai i cili merr përsipër që t’i këshilloj krijesat e Allahut. O ju të dashurit e mi, ju këshilloj që të kapeni fort pas dijetarëve të Sunetit dhe të shoqëroheni me pasuesit e Sunetit, si dhe kini kujdes nga shoqëria e pasuesve të epsheve dhe bidateve, sepse ajo shoqëri lë puçrra në zemër siç janë puçrrat e zgjebes. Shoku është tërheqës (të tërheq në të mirën apo të keqen e tij, sh.p) dhe ai me të cilin ulesh është i ngjashëm me ty.

Mos pyet për njeriun dhe shiko shokun e tij, kështu që çdo shok udhëzohet me atë që bashkohet. Njeriu është në fenë e shokut të tij, andaj le të shikoj secili prej jush se me kë shoqërohet. Siç ka thënë Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtim i Allahut qoftë mbi të* –:

لَا تُصَاحِبْ إِلَّا مُؤْمِنًا وَلَا يَأْكُلْ طَعَامَكَ إِلَّا تَقِيٌّ

“Mos u shoqëro vetëm se me besimtarin dhe mos ta haj ushqimin tënd vetëm se i devotshmi.”

Ki kujdes nga shoqërimi me pasuesit e epsheve, sepse ata kanë puçrra sikurse puçrrat e zgjebes. Me të vërtetë adeti dhe zakoni i kozmosit, zakoni i Allahut që vazhdon dhe e kanë mësuar njerëzit është se ajo që është e zgjebosur nuk përfiton duke ndenjur afër të shëndoshës, porse ajo që është e shëndoshë dëmtohet duke ndenjur afër të zgjebosurës. Ti vjen me një deve të shëndoshë dhe do ta bashkosh me një deve të zgjebosur, dhe thua se ndoshta e zgjebosura do të shëndoshet. Ky është një krahasim i mangët. Por, largoje të shëndoshën nga e zgjebosura, në mënyrë që mos e kaplojë zgjebja e të zgjebosurës, ky është krahasim i saktë.

Prandaj, një poet i vjetër thotë:

“Nuk i bën dobi të zgjebosurës afrimi i të shëndoshës,
por ajo që është e shëndoshë, do zgjeboset.”

Kështu që, nëse ti mendon se do të udhëzohesh duke ndenjur afër një pasuesi të epsheve, atëherë ti e ke rrezikuar veten tënde dhe rrezikimi i vetes tregon për logjikën e dobët. Nuk ka ndonjë lidhshmëri të ndërsjellë në mes këshillës dhe shoqërimit. Ti ke

mundësi ta këshillosh dhe të rrish larg tij, porse ta shoqërosh atë, atëherë kjo është një gjë shkatërrimtare dhe rrënuese si dhe bie ndesh me atë që ishin Selefët tanë të devotshëm, madje kjo bie ndesh me Librin e Zotit tonë dhe Sunnetin e të Dërguarit tonë – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –, dhe është në kundërshtim me atë që ishin Selefët tanë të devotshëm.

Nuk erdhi kjo luhatje (në fe) tek të rinjtë dhe të moshuarit përveç se me afrimin e të shëndoshit me atë që ka zgjeben. I shëndoshi nuk ka dobi nga i zgjebosuri, dhe i zgjebosuri nuk ka dobi nga i shëndoshi, por i shëndoshi dëmtohet nga i zgjebosuri. Kështu që, ky është një parim i shëndoshë dhe i njohur.

E lusim Allahun – të Pastrin nga çdo e metë dhe të Lartësuarin – që të na jap sukses në çdo mirësi dhe të na largoj neve dhe juve nga çdo sherr dhe të na mbroj ne dhe juve nga devijimet e fitneve nga ato që janë të dukshme dhe të fshehta. Vërtetë Ai është Bujari Fisnik.

Lëvdata, shpëtimi dhe begatia e Allahut qoftë mbi robin e Tij, të Dërguarin e Tij, Pejgamberin tonë Muhamedin, dhe mbi familjen e tij si dhe mbi të gjithë shokët e tij.

Burimi: <http://www.sahab.net/forums/index.php?showtopic=141193>

Përktheu: Jeton Shasivari

22 Sh'aban 1435

20 Qershor 2014

Medine